



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 708, Datë 23.09.2020

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.09.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003);
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”,

VËREN SE :

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një ankesë mbi disa praktika abuzive, me qëllim shtrembërimin dhe kufizimin e konkurrencës gjatë pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve të zhvilluara nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), Posta Shqiptare, UKT, OSHEE dhe UKD.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ankesës së paraqitur rezultoi se gjatë pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve të zhvilluara nga AKBPM, Posta Shqiptare, UKT, OSHEE dhe UKD, vihet re se.

- Kur numri i ofertuesve pjesëmarrës në këto procedura është i vogël, ofertat e paraqitura prej tyre janë shumë afër fondit limit dhe ndryshojnë shumë pak nga njëra-tjetra, ndërsa kur pjesëmarrja e ofertuesve është e madhe, vlerat e ofertave të paraqitura janë shumë më të ulëta në raport me fondin limit;

- Në disa raste ofertuesit rezultojnë fitues me rrotacion duke mbështetur njëri-tjetër nëpërmjet paraqitjes së ofertave fiktive të cilat përmbajnë terma specifike të papranueshme nga blerësi (autoriteti kontraktor);
- Kjo sjellje hedh dyshime për një bashkëpunim të mundshëm midis këtyre operatorëve ekonomik duke mbështetur njëri-tjetër në këto procedura me qëllim fitimin e tenderit me ofertën më të lartë dhe rrotacionin e fituesit.

Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, kjo sjellje hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis operatorëve në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.) të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare SHA, UKT, OSHEE dhe UKD”, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga Janari 2018 deri në Dhjetor 2019.
- Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Eduard YPI

()

Zy Kryetar

Leida MATJA

()

Anëtar

Adriana BERBERI

()

Anëtar

Helidon BUSHATI

()

Anëtar

Juliana LATIFI

()

Kryetar